

**STRATEGJIA E KËRKIMIT  
SHKENCOR  
KOLEGJI UNIVERSITAR TBU  
PËR VITET AKADEMIKE  
2018 - 2024**

**TIRANË, DHJETOR 2018**

## 1. Ecuria e kërkimit shkencor deri në fund të vitit akademik 2017-18

Në Shtator 2018, Tirana Business University College (TBU) përmbylli vitin e tetë akademik të veprimtarisë së vet që nisi në Tetor 2010. Aktiviteti i derisotëm u bazua në një strategji zhvillimi që u ndryshua e përmirësua gjatë rrugës.

Objektivi parësor në 2-3 vitet e para ishte formësimi i plotë i strukturave organizative dhe programore dhe arritja e diplomimit të brezit të parë të studentëve bachelor dhe master si dhe përmbyllja e akreditimit të parë institucional dhe programor. Në vitet e tjera objektivi kryesor ka qenë arritja e treguesve të lartë të punësimit të studentëve bachelor përpara diplomimit ndërsa për studentët master ngjitja në karrierë. Gjithashtu objektivi ka qenë edhe arritja e pikës së vetëfinancimit të shkollës nga të ardhurat primare të vetat, pra e autonomisë financiare dhe e mundësive për vetë zhvillim me burime të brendshme të shkollës. Në të gjitha këto drejtime rezultatet janë të larta.

Drejtimi shkencor përbënte një nga drejtimet prioritare të strategjisë së parë të zhvillimit të një kapitulli më vete në këtë strategji. Gjithsesi, koha tregoi se objektivat tona mbi kërkimin shkencor ishin më ambicioze se mundësitë ndërkohë që burimet e kufizuara në dispozicion duheshin përdorur në radhëtë parë për objektivat e tjera. Ndaj strategjia e zhvillimit u riformulua në Nëntor 2014 duke ridimensionuar në baza më realiste, ndër të tjera, edhe objektivat tona mbi kërkimin shkencor.

Ndonëse në plan dytësor, kërkimi shkencor është trajtuar me seriozitet dhe vëmendjen që i takon në raport me rastin e një shkolle si TBU e cila, si kolegji universitar me 2 fakultete, ka dhe do të ketë një numër të vogël studentësh – rreth 500 gjithsej – duke u klasifikuar kështu në kategorinë e kolegjeve universitare të vogla të cilat edhe vetë ligji 80/2015 i arsimit të lartë i trajton me disa ndryshime specifike siç është ai mbi numrin e pedagogëve me kohë të plotë.

Sipas marrëveshjes së arritur me Ministrinë e Arsimit në Nëntor 2018, bazuar në nenet 17/6 dhe 25/4 të ligjit, TBU duhet të ketë të paktën një pedagog me kohë të plotë për çdo njësi bazë nga të paktën 7 për njësi bazë që kërkohen në rastin e kolegjeve të tjera universitare kur numri i studentëve është me i madh se 600.

Ky diferencim edhe nga vetë ligji nënkupton se fuqia kërkimore-shkencore bazë e TBU, e cila në shkollat e larta bazohet kryesisht tek pedagogët me kohë të plotë, është numerikisht mjaft modeste, në numër njerzish dhe në orë pune/vit krahasuar me rastin e kolegjeve të tjera universitare të cilat stafin akademik me kohë të plotë në 6 njësi bazë minimale duhet ta kenë më të paktën 42 vetë.

Gjithashtu, numri i vogël i studentëve dikton edhe një numër të vogël të studentëve që ndjekin program master i shkencave, në të cilin merr një peshë të rëndësishme formimi shkencor dhe aftësimi i studentëve në metoda kërkimi apo pjesëmarrja e tyre në kërkim shkencor. Grupi i studentëve që ndjekin master i shkencave në TBU në 2 vite akademike sëbashku nuk e ka kaluar ndonjëherë numrin 43 vetë gjithsej.

Në këto rrethana objektive, TBU ka bërë maksimumin e mundshëm në drejtim të kërkimit shkencor, aktivitet ky që ka ardhur në rritje veçanërisht në 2 vitet pararendëse akademike.

Drejtimet kryesore që kemi ndjekur për krijimin e parakushteve të duhura për një kërkim shkencor në rritje gjatë viteve të kaluara kanë qenë:

- Sfati akademik me kohë të plotë është rritur në numër përtej numrit minimal të përcaktuar nga marrëveshja me Ministrinë e Arsimit. Numri i tyre arriti në 18 vetë në vitin akademik 2017 – 18. Prej këtyre 8 janë me Dr/PhD ose Prof.As.Dr dhe Prof.Dr. Çdo njësi bazë drejtohet nga një titullar me të paktën DR/PhD. Gjithashtu 3 vetë nga stafi me kohë të plotë janë në proces të zhvillimit të studimeve doktorale. Viti akademik 2018 – 19 ka nisur me 28 pedagogë me kohë të plotë
- Stafi akademik me kohë të pjesshme dallohet si për përvojën e drejtpërdrejtë në punë por edhe sepse një pjesë e mirë e tyre kanë tituj dhe/ose grada ose kanë kryer një studim të ciklit të tretë (Master ekzekutiv apo shkollë magjistrature), 17nga 38 gjithsej. Mes tyre 3 janë në proces të ndjekjes së PhD.
- TBU kërkon të angazhohen në kërkim shkencor dhe botime shkencore edhe stafi akademik me kohë të plotë edhe ai me kohë të pjesshme. TBU përdor stimuj financiarë për këtë qëllim. Kështu, stafi akademik me kohë të plotë ka të inkorporuar në pagën e vet pjesën e orëve të punës vjetore që duhet ti kushtohen kërkimit shkencor vetjak, për udhëheqje diplome apo në kërkimin institucional të TBU. Në një farë mase, por mjaft më të vogël kjo vlen edhe për pedagogët me kohë të pjesshme, tarifa orare e të cilëve nënkupton edhe vetëzhvillimin përmes kërkimit shkencor vetjak të pedagogut dhe perfshirjen në udhëheqjen e diplomave. Në totalin e vet vlerësohet se kosto për orët e punës vjetore të dedikuar për kërkimin shkencor arrijnë rreth 16% të shpenzimeve vjetore gjithsej të TBU.
- Stafit akademik i është dhënë mundësia e botimit të kërkimit shkencor në konferencat që organizohen nga TBU dhe “International Institute for Private, Commercial and CompetitionLaw” dhe në botimin periodik shkencor të këtij instituti e ku, në të dy rastet TBU është bashkëpunëtorë e së fundmi edhe bashkëbotuese. Stafi akademik ka qenë i lirë dhe i nxitur të marrë pjesë në konferenca dhe botime të tjera.
- Përmes projektit Erasmus (ICM Project) me fonde të BE, në vitin 2018, 5 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë zhvilluan një periudhë 2 javore specializimi në universitetin e Staffordshire në UK e së shpejti do të fillojë zbatimi i të njejtit projekt Erasmus gjatë periudhës 2019-2020 me këtë universitet.
- TBU arriti të aplikojë me dy projekte kërkimore në Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor në shtator 2018 – njëri në bashkëpunim me Universitetin Polis dhe tjetri me Çelsi Media Grup, e ku në të parin TBU është partner udhëheqës. TBU ka aplikuar edhe në Fondin ballkanik për Zhvillim me njëjtjetër prjojekt në nivelin që perfshin Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë.
- TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi që përfshijnë edhe bashkëpunimin për kërkimin shkencor me universitete të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj si me UET, Staffordshire University (Angli), FH Bielefeld (Gjermani), etj dhe jemi në hapat e parë të konkretizimit të këtyre marrëveshjeve me projekte konkrete.

- TBU riorganizoi strukturën e kërkimit shkencor duke bashkuar në një qendër kërkimore dy ish-qendrat e secilit fakultet dhe në drejtim të qendrës është vendosur një staf me përvojë e lidhje ndërkombëtare në kërkim shkencor dhe me shkollim PhD në Universitetin e Triestes. Ky ndryshim filloi të japë menjëherë efektet e veta.
- Gjithashtu në të gjitha departamentet krijohen grupe ad-hoc për qëllime kërkimore-shkencore, të cilat bashkëpunojnë edhe me Qendrën kërkimore për realizimin dhe zbatimin e projekteve të tyre kërkimore.
- Stafi akademik i TBU që ka kryer studime universitare dhe pasuniversitare në universitetet të nivelit të lartë në vendet e OECD (13 prej tyre), ka qenë një tjetër aset në përfshirjen në rritje vit pas viti të TBU në kërkimin shkencor institucional.
- Në programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi është rritur pesha e lëndëve mbi kërkimin shkencor. Kështu, nga vetëm një lëndë semestrale që kryhej më parë mbi metodat e kërkimit, në vitin akademik 2017 – 18 kjo fushë u lëvrua me 2 lëndë semestrale duke dyfishuar numrin e orëve e gjithashtu u krye nga 2 pedagogë njëkohësisht duke mundur kështu një parapërgatitje më të fortë të studentëve për temën e tyre të diplomimit që do të mbrohen përgjatë vitit akademik 2018 – 19.
- Në nivelin master, përfshirë edhe atë profesional, është rritur numri i orëve brenda lëndëve të caktuara në të cilat studentët angazhohen në mbledhjen metodike të të dhënave dhe analizën e tyre me qëllim përgatitjen e një detyre kursi apo eseje bazuar edhe mbi metodologji shkencore, cilësore ose sasiore
- Rritje e volumit të orëve të angazhimit të studentëve në procese të aftësimit fillestar apo bazik në kërkim shkencor kemi patur edhe në programin bachelor, veçanërisht me studentët me nivel të lartë në rezultatet mësimore dhe kandidatë të mirëfilltë për të vijuar studimet në master i shkencave.
- Gjithashtu, në nivelin bachelor, në programin Administrim Biznesi, përmirësim të ndjeshëm kanë patur lëndët e matematikës, statistikës, informatikës si premisë e domosdoshme për kërkim shkencor ndërsa në programin e te Drejtës së Biznesit u zhvillua për herë të parë lënda “Hyrje në Logjikën Formale”.
- Prej vitit akademik 2014 – 2015 e në vijim TBU ka akses në biblioteken elektronike EBSCO online. Çdo pedagog dhe student i TBU ka akses të lirë në këtë bibliotekë dhe shkalla e shfrytëzimit të literatures ofruar nga EBSCO ka ardhur në rritje nga viti në vit.
- TBU ka instaluar një bazë kompjuterike shumë të fuqishme. Ne gjithë shkollën janë instaluar 82 Desktop/lap top, të gjithë të lidhur në rrjet dhe me akses në internet. Nurmi i tyre është trefishuar krahasuar me 4 vite më parë. Çdo auditor ka kompjuterin dhe projektorin e vet. Në sallën e bibliotekës së shkollës janë instaluar 35 kompjutera

në dispozicion vetëm të studentëve. Çdo pedagog me kohë të plotë ka vendin e tij të punës të mirëpajisur. Disa vende të tjera pune të pajisura me të gjitha mjetet janë në dispozicion të pedagogeve me kohë të pjesshme.

- Mjediset e TBU janë komode dhe të përshtatshme për tu përqëndruar në punën kërkimore ndërsa orari ditor i punës së pedagogeve dhe kalendari vjetor është mjaft fleksibël që ata të përballojnë edhe mësimdhënien edhe të merren me kërkim shkencor.
  - Sëbashku me pjesën e pagës së dedikuar për kërkim shkencor, shpenzimet për abonim në librarinë elektronike, shpenzime për pjesëmarrje në konferenca si dhe investime të tjera në hard dhe software si premisë për kërkim shkencor llogaritet se përbënin rreth 21% të totalit të shpenzimeve vjetore të TBU në vitin akademik 2017 – 18.
- Mbi këto premisa aktivitetet kërkimore në TBU e kanë rritur volumin e tyre në 3 vitet e fundit akademike krahasuar me 5 vitet e para. Duke filluar nga Viti Akademik 2014-2015 dhe deri në 2017 – 2018, çdo vit TBU ka organizuar të paktën katër konferenca shkencore në bashkëpunim me “International Institute for Private, Commercial and Competition Law”.
- Gjithashtu gjatë Vitit 2017-2018 u realizua një marrëveshje midis TBU dhe “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” për të bashkëpunuar nëbotimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” me ISSN 2410-759X, e cila botohet në Austri 3 herë në vit (Janar, Maj dhe Shtator).
- Duke filluar që nga viti akademik 2016-2017 e në vazhdim TBU ka marrë pjesë në 8 aplikime të ndryshme për projekte Erasmus për shkëmbim stafi dhe studentësh si edhe ne projekte të tjera për kërkimin shkencor (të përmendura më lart).

## **2. Proçesi i hartimit të strategjisë së kërkimit shkencor 2018-24**

Sipas rekomandimit të dhënë nëproçesin e riakreditimit institucional, TBU duhet të ketë edhe një strategji të veçantë për kërkimin shkencor me një rol adekuat të njësive bazë. Siç u shpjegua edhe në pjesën e parë, kërkimi shkencor ishte trajtuar si një kapitull më vete në strategjinë e zhvillimit 2012 – 2018, por tashmë ai do të trajtohet me një dokument më vete.

Për këtë qëllim, me urdher të rektorit 10.01.2018 u ngrit një grup pune ndërdepartamental, nën udhëheqjen e Qendrës për Kërkime Ekonomike dhe Juridike në Fakultetin e Drejtësisë. Në grup morën pjesë drejtuesit e të gjitha departamenteve. Grupi zhvilloi një numër takimesh dhe shumë diskutime për të arritur në një dokument strategjik të mirë orientuar dhe udhëheqës për punën e mëtejshme zbatuese e konkretizuese nga çdo njësi bazë dhe fakultet. Dokumenti fillestar u diskutua në dekanate e më pas në senat si edhe në bordin e administrimit për t’u miratuar në Dhjetor 2018.

Proçesi i hartimit të strategjisë së kërkimit shkencor u harmonizua edhe me atë të hartimit të strategjisë së zhvillimit për të njejtën periudhë.

### 3. Strategjia e kërkimit shkencor 2018 – 24

Në gjashtëvjeçarin e ardhshëm kërkimi shkencor në TBU do të ketë një peshë më të lartë se në vitet pararendëse. Konkluzioni i përgjithshëm ishte se, në rrethanat specifike të TBU, ndonëse në kërkimin shkencor nuk duhet të kemi pretendime përtej kapaciteteve njerëzore që disponojmë, gjithsesi me këto kapacitete, mjete, dhe fonde që kemi e që do vijmë në rritje, TBU mund të bëjë shumë më shumë se ç'ka bërë deri më sot.

Qellimi i kërkimit shkencor në TBU është i trefishtë:

- a. Aftësimi në kërkim shkencor, përmes përvetësimit të metodave dhe përfshirjes në kërkim shkencor, është pjesë e domosdoshme e formimit profesional të studentëve. Jo vetëm studentët në programin master i shkencave por edhe studentët që do të zhvillojnë karrierë profesionale në punë kanë nevojë për një minimum aftësish kërkimore. Aq më shumë studentët me rezultate të larta e që synojnë karrierë kërkimore dhe akademike, për të cilët ky formim është një domosdoshmëri.
- b. Kërkimi shkencor dhe aftësimi në kërkim është pjesë e natyrës së akademikut, një mënyrë jetese e tij, një liri e patjetërsueshme e tij e cila duhet mbështetur e nxitur. Nga ana tjetër, aftësimi i stafit në kërkim shkencor përmes përfshirje në këto kërkime është premisë më e parë për t'i shërbyer më mirë edhe studentëve edhe vetë institucionit TBU.
- c. Vetë TBU, si institucion universitar, ka ambicjet e veta institucionale në kërkimin shkencor dhe synon të inkorporojë në arkivën e vet dije të reja, të aksesueshme lirisht, e të kontribuojë në dijet vendase dhe globale, në mos në dijet teorike, të paktën në ato aplikative, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë dhe koordinim të punës së stafit akademik, njësisive bazë dhe Qendrës për Studime Ekonomike dhe Juridike.

Mbi këto tre qëllime TBU, brenda mundësive të veta financiare por që do vijmë në rritje, do të fuqizojë faktorët bazë që mbështesin rritjen e volumit, të cilësisë dhe dobishmërinë e natyrisht edhe etikën e kërkimit shkencor që do të kryhet në 6 vitet pasardhëse.

Mbështetur në këto premisa Qendra për Kërkime Ekonomike e Juridike merr një rol parësor në mirëorientimin e kërkimit shkencor në bashkëveprim me departamentet lëndore të cilat duhet të udhëheqin punën kërkimore në fushat perkatëse, me theks kërkimin shkencor aplikativ dhe/ose njohjen, analizimin dhe parashikimin e fenomeneve që ndodhin apo pritet të ndodhin në mjedisin ekonomik, social, institucional e ligjor në Shqipëri.

- Premisa më e parë që duhet fuqizuar është ajo e kapaciteteve njerëzore. TBU do të konsiderojë shtimin, natyrisht të matur, të numrit të stafit akademik me kohë të plotë. Kjo do të sjellë edhe shtimin e burimit njerëzor edhe shtimin e orëve të punës vjetore në dispozicion të kërkimit shkencor. Parashikohet që shpenzimet për kërkim shkencor, si pjesë e pagës së pedagogëve, të arrijnë të paktën 25% të totalit të shpenzimeve të TBU në fund të 6-vjeçarit. Në këtë mënyrë çdo anëtar i stafit akademik do ketë më shumë kohë në dispozicion për të vijuar ngjytjen në karrierën akademiko-shkencore si arritje individuale por edhe të kontribuojë më shumë si në formimin shkencor të studentëve ashtu edhe në projektet kërkimore departamentale apo institucionale.

- Krahas rritjes së orëve në dispozicion, TBU do të përmirësojë mënyrën e normimit të përdorimit të kësaj kohe dhe lidhjen e saj në mënyrë stimuluese me pagën/shpërblimet, bazuar në parimin se kush kontribuon më shumë në kërkim shkencor do të marrë një shpërblim më të madh. Deri më sot, pjesa e pagës e lidhur me kërkimin shkencor është dhënë pavarësisht shkallës së angazhimit të stafit përkates.
- Në varësi të fondeve të brendshme të dedikuara për shpenzime direkte kërkimore apo të fondeve që do të fitohen nga aplikime të ndryshme, TBU do të mund të angazhojë edhe staf kërkimor të jashtëm apo për periudha të caktuara sa kohëzgjatja e projektit përkates. Kjo do të sjellë shtim të fuqisë njerëzore në kërkim shkencor.
- TBU do të zgjerojë bashkëpunimin me universitete shqiptare dhe të huaja edhe në drejtim të kerkimit shkencor. Arritjet e para në këtë drejtim janë inkurajuese. Në veçanti do të rritet ndjeshëm numri i projekteve të aplikuara në fondet europiane për kërkim shkencor kombinuar me fonde për shkëmbim stafesh dhe studentësh apo për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe botime periodike shkencore. Nga 8 projekte të aplikuara në 2 vitet akademike 2016-18 (2 të fituara e njëri i zbatuar, 3 në pritje të rezultatit) synohet që të aplikojmë në të paktën 32 projekte në 6 vitet e ardhshme. Këtu bëhet fjalë për projekte të aplikuara si institucion pa llogaritur projekte të ndërmarra në pedagogë apo grup pedagogësh.
- TBU do të nisë një bashkëbisedim me kompani dhe banka të mëdha për të vlerësuar interesin e tyre për shërbime konsulence me elemente të kerkimit shkencor ose për produkte kërkimore-shkencore të mirëfillta. Natyrisht që në këtë drejtim duhet konsideruar edhe stadi aktual i Kërkim Zhvillimit (R&D) në sektorin privat i cili është ende në fazën latente, ndaj synimet do të jenë shumë të matura.
- Përvetësimi i metodave fillestare e bazë të kerkimit shkencor do të fuqizohen në programet bachelor dhe master profesional ndërsa duhet të arrijnë një nivel mjaft më të lartë akademik në programin master i shkencave. Në nivelin bachelor, studentët cilësorë duhen trajtuar në mënyrë më të personalizuar veçanërisht lidhur me aftësimin e tyre në kërkim shkencor duke i'u ofruar lëndë apo module shtesë dhe/ose duke i përfshirë në projekte kërkimore apo duke i udhëhequr në tema diplome me elementë të spikatur të metodave kërkimore.
- Një sfidë e veçantë do të jetë konceptimi i kerkimit shkencor në Programin Master i shkencave në Drejtësi (profili E Drejtë Biznesi). TBU duhet të shkëputet qartazi nga rutina e gjithëpërhapur se master i shkencave, në juridik veçanërisht, nuk është gjë tjetër veçse 2 vite shkollë më shumë e ca lëndë më shumë apo të njëjtat lëndë me shtesë tematike. Në fakt sistemi i integruar 5-vjeçar në Drejtësi, diploma e të cilit është Master i Shkencave është ende pa një model që pritet të dalë me udhezim nga Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve, ende i panjohur për të gjitha shkollat e larta dhe me kundërshti të brendshme që duhen adresuar me kujdes.

- Për rritjen e shkallës së përfshirjes në kërkim shkencor të studentëve, TBU do të fillojë të japë edhe çmime me shpërblim financiar për temat më të mira të diplomave, projekte, ese-ve, artikujve të botuar nga studentët. Ky fond do të fillojë të aplikohet që në vitin akademik 2018-19.
- TBU do të kërkojë e nxisë një përdorim me efektiv të literaturës që ofrohet nga EBSCO online. Ndonëse shkalla e përdorimit ka ardhur në rritje, ende niveli i përdorimit të këtij burimi nga pedagogët dhe studentët është larg mundësive të mëdha që ai ofron. Kur të konstatohet një shkallë e lartë optimale e përdorimit të këtij burimi TBU do të konsiderojë të përballojë kosto të tjera shtesë për akses edhe në ndonjë librari tjetër elektronike. Shkalla e aksesit të studentëve dhe pedagogeve në EBSCO do të shërbejë si një kriter i ri shtesë vlerësimi.
- Baza kompjuterike e TBU është e mjaftueshme për 6 vitet e ardhshme dhe nuk kërkohen shuma të konsiderueshme për investim. Ndaj, fondet për investim në kërkimin shkencor do të orientohen më shumë në drejtim të financimit të aktiviteteve kërkimore në projekte të caktuara apo për pjesëmarrje në konferenca kombëtare e nderkombëtare të pedagogëve dhe studentëve tanë.

#### **4. Buxheti në mbështetje të strategjisë së kerkimit**

Në tetë vitet e para të aktivitetit të vet TBU ka patur në dispozicion një buxhet afro 280 milion lekë. Nga këto, jo më shumë se 40 milion lekë kanë qenë burim financimi, direkt dhe indirekt, për kërkimin shkencor. Sipas strategjisë së zhvillimit, buxheti në total për TBU në 6 vitet e ardhshme parashikohet rreth 420 milion leke, pa llogaritur këtu fonde që mund të fitohen nga projekte dhe donacione të ndryshme. Nga shuma prej 420 milion lekë të paktën 120 milion do të jenë fond për të financuar shpenzime direkte dhe indirekte për kërkim shkencor. Vetëm këto përbëjnë një burim të konsiderueshëm për arritjen e një nivel mjaft më të lartë të kërkimit shkencor në TBU. Nëse këtyre fondeve do u shtohen edhe fonde të fituara nga projekte e donacione, kapaciteti kërkimor shkencor i TBU do të 2 – 3 fishohet.

#### **5. Detyrat e strukturave akademike dhe administrative**

Bazuar në këtë strategji, strukturat akademike (senati, dekanatet dhe departementet, komisionet dhe njësitë e tjera) si dhe strukturat administrative (Bordi Administrativ, Administratorët, zyrat mbështetëse) do të zhvillojnë planin e posaçëm të punës që do të ndërmerret për zbatimin me efektivitet dhe efikasitet të strategjisë së kërkimit shkencor dhe arritjen e objektivave të saj vit pas viti.

Çdo njësi organizative statutore, krahas ndjekjes në vijimësi të detyrave të percaktuara për vitin akademik 2018-19, e që është viti i parë i zbatimit të strategjisë së kërkimit shkencor, të përgatisë planin e punës, për pjesën përkatëse të detyrave për vitin akademik 2019-20. Drafti i parë i çdo plani duhet të jetë perfunduar brenda Qershorit 2019 e t'i percillet organit më të lartë apo epror sipas rastit.

Plani i punës së departamenteve që lidhet me çështjet akademike në kërkimin shkencor koordinohet nga Qendra e Kërkimeve Ekonomike e Juridike në bashkëpunim me Zv. Rektorin. Çdo departament duhet të ndërtojë një plan të individualizuar të kerkimit shkencor.



Gjithashtu, çdo pedagog me kohë të plotë duhet të ketë një plan individual të angazhimit në kërkim shkencor.

Për çështjet administrative që lidhen me kërkimin shkencor plani i punës zhvillohet nga administratorët e fakulteteve në bashkëveprim me administratorin e shkollës dhe Bordin e Administrimit.

Në tentativë, plani i punës mbi kërkimin shkencor dhe program i temave kerkimore shkencor (institucionale, departamentale dhe individuale e pedagogëve) për vitin akademik 2019 – 20 duhet të paraqitet në Senatin Akademik brenda muajit Korrik 2019.